REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 25 / 06 / 2025
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 170 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 3
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERZIAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

# Procesverbal nga konsultimi publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 (KAB), i mbajtur nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës si dhe anëtaret e KPF-së

Me datën 24 Qershor 2025, është mbajtur konsultimi publik i organizuar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Xhavit Zariqi, bashkë me anëtarët e KPF-së.

Njoftimi për mbajtjen e takimit publik është publikuar me 18.06.2025 në uebfaqe të komunës në vegëzën:

https://ferizaj.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2025/06/Njoftimi-Shqip.pdf

Njoftimi është publikuar edhe në platformën e konsultimeve publike:

https://konsultimet.rks-gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=42834

Në këtë konsultim publik ka marrë pjesë kryesuesi Xhavit Zariqi, Arian Imeri-anëtar i KPF-së, Mimoza Sojeva-Pajaziti-anëtare e KPF-së, Lulzim Abazi anëtar i KPF-së, Flamur Istrefi-anëtar i KPF-së si dhe Brahim Osmani-anëtar i KPF-së.

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

Poashtu kanë marrë pjesë kryetarët e zonave urbane dhe rurale të qytetit, mediat dhe shoqëria civile.

Në këtë takim publik kanë marrë pjesë 16 qytetarë 4 femra dhe 12 meshkuj.

Hapjen zyrtare të këtij takimi e ka bërë kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Ferizajt, Xhavit Zariqi, i cili ka thënë se këto takime janë shumë të rëndësishme për të marr ide dhe propozime për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Pas fjalës së tij, kryesuesi fjalën ja kaloi qytetarëve pjesëmarrës në këtë takim.

Adnan Reka-Prelez i Muhaxherve

- Pse nuk po behet rregullimi i parkut te gjelbert në këtë fshat, ku është paraparë që të ketë drunjë dekortaiv dhe hapësirat sportive dhe rekreative për të gjitha grupmoshat?
-
- Muhamet Azemi
  - Të vendosen shenja ne rrugën "Syri i kaltert", sepse nuk asnjë shenje
  - Të bëhet largimi i mbeturinave në lagjën "Graiqevci" në fshatin Prelez i Jerlive

Rasim Qerkini- Ferizaj

- Të bëhet rregullimi i rrjetit të kanalizimit në lagjën time, sepse kemi problem nga futja e ujit në oborr.

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr."Dëshmorët e Kombit" p.n.

Visar Heda-Varosh

- Të bëhet asfaltimi i rrugëve brenda për brenda fshatit Varosh
- Të bëhet hapja e kanalizimit në fshat k
- Të bëhet ndriçimi publik në ato lagje ku nuk është
- Të bëhet përmirësimi i kushteve në shkollën fillorë "Visar Dodani" në Varosh
- Të bëhen trotuaret në disa lagje të fshatit
- Të bëhet një parking të xhamia e fshatit
- Të bëhet përfshirja e fshatit Varosh në trafikun urban të qytetit

Betim Syla

- Të bëhet certifikimi i kryetareve të fshatrave dhe zonave urbane

Pas këtyre kërkesave kryesuesi Xhavit Zariqi, është shprehur se këto propozime do të diskutohen me ekzekutivin komunal dhe do të shikohen që të inkorporohen në Kornizën Afatmesme Buxhetore.

Ky konsultim publik përfundoj në orën 11:00

Procesmbajtëse

Shyhrete Topalli